



Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisije Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
E LIDHUR NË MES:
KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK
DHE
ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Kjo Marrëveshje ka për qëllim të lehtësojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve;

Me qëllim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës në fushën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës;

Me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të palëve sipas fushë veprimtarisë së caktuar për interesa të përbashkëta;

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve përmes edukimit të vazhdueshëm, trajnimit dhe certifikimit të auditorëve të caktuar; dhe

Me qëllim të lehtësimit të komunikimit mes palëve dhe zbatimit sa më efikas të aktiviteteve audituese, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (këtu e tutje: KRPP), lidh këtë memorandum bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit (këtu e tutje: ZKA).

Palët e kësaj marrëveshjeje u pajtuan si në vijim:

Neni 1
Kontributi i KRPP-së

1. Merr përsipër që sipas nevojave dhe planit të ZKA, të organizojë trajnime në grup për auditorët e ZKA-së, në lidhje me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren dhe Udhëzuesin Operativ për prokurim publik, përdorimin e sistemit *e-prokurimi*, si dhe prezantimin e ndryshimeve, kurdo që ato aplikohen për Autoritet Kontraktuese (AK);

2. Merr përsipër që të lëshojë certifikatë të pjesëmarrjes, për të gjithë auditorët pjesëmarrës në trajnime;
3. Merr përsipër që t'i trajtojë me prioritet kërkesat për interpretim të Ligjit të Prokurimit Publik që parashtrihen nga auditorët, dhe të kthejë përgjigje sa më shpejtë që të jetë e mundur;
4. Fton ZKA-në në konferencat, punëtoritë që i organizon lidhur me Ligjin për Prokurimin Publik, si dhe merr pjesë në ato që i organizon ZKA-ja;
5. Kurdo që KRPP e vlerëson të nevojshme, njofton ZKA-në për çështje që ndërlidhen me moszbatim të legjislacionit për prokurimin publik nga ana e AK-ve; dhe
6. Cakton një person nga KRPP-ja në pozitën e koordinatorit/zyrtarit ndërlidhës mes KRPP-së dhe ZKA-së që kujdeset për zbatimin sa më efektiv dhe efikas të pikave 1-5 më lartë.

Neni 2 Kontributi i ZKA-së

1. Përgatit listën për trajnimet e nevojshme, koordinohet me KRPP-në për listën dhe planin e trajnimeve, që përfshijnë trajnimet për e-prokurimi dhe për Ligjin e Prokurimit Publik, rregulloret, Udhëzuesin Operativ dhe manualët e prokurimit.
2. Kërkon nga KRPP, kurdo kur e sheh të nevojshme, të marr pjesë në trajnimet që organizohen për AK-të për të gjitha ndryshimet që planifikohen apo realizohen nga KRPP.
3. Fton KRPP-në në konferencat, punëtoritë që i organizon lidhur me Prokurimin Publik, si dhe merr pjesë në ato që i organizon KRPP-ja.
4. Cakton një person nga ZKA-ja në pozitën e koordinatorit/zyrtarit ndërlidhës mes ZKA-së dhe KRPP-së që kujdeset për zbatimin sa më efektiv dhe efikas të pikave 1-3 më lartë.

Neni 3 Komunikimi dhe mbulimi i shpenzimeve

1. Palët do të shkëmbejnë të gjitha informacionet me shkrim, përmes komunikimit elektronik zyrtar.
2. Palët do të ndajnë shpenzimet lidhur me organizimin e konferencave/punëtorive të përbashkëta.


Neni 4 Hyrja në fuqi dhe afati

Palët pajtohen që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe nuk ka afat, ndërsa mund të shkëputet apo ndryshohet me njoftim paraprak me shkrim prej shtatë (7) ditësh.

E nënshkruar në Prishtinë, më 06.10.2022



Osman Vishaj - Kryetar i KRPP-së



Vlora Spanca - Auditore e Përgjithshme, ZKA